**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **31.01.2024** |
| **REFERENC-Ë:** | 02-052/01-0007068/24 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **z. Bedri Hamza, Kryetar i Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **znj. Drita Kadriu, Drejtore e Arsimit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Shkresë përcjellëse** *( Raporti i grupit punues për "Draft Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026")* |

# RAPORT

## NGA TUBIMI ME PUBLIKUN PËR *"DRAFT PLANIN E VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026"*

### Hyrje

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komuna e Mitrovicës harton raport të tubimit me publikun për *"Draft planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026"* është mbajtur me datën 23.01.2024, në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 14:00.

### Ecuria e procesit të takimit

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes:

https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/njoftime-per-konsultime-publike/

në rrjetet sociale të Komunës së Mitrovicës (Facebook, Instagram). Njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të Komunës.

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet KPF-së, Kuvendit të Komunës, si dhe të gjitha drejtorive.

**Pjesëmarrësit/kontribuuesit**

Të pranishëm ishin 25 pjesëmarrës, si në vijim :

- *Anëtarët e grupit punues* për hartimin e *"Draft planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026"* në bazë të Vendimit me nr .prot. *07-020/04-0078247/23* të datës *23.10.2023.*

- *Përfaqësues të DKA-së;*

- *Zyra e Informimit të Komunës së Mitrovicës.*

Në takim kishte shumë diskutime, sidomos nga përfaqësuesit e EPRBM-ve shkollore të cilët dhanë kontribute të vyeshme në *"Draft planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026"*. Po ashtu e vlerësuan si të domosdoshëm zbatimin e këtij plani për parandalimin e braktisjes së shkollimit.

Të gjithë mësimdhënësve dhe personelit arsimor u është dërguar draft rregullorja (përmes drejtorëve të shkollave) në adresa elektronike të tyre ku kanë pasur mundësi ta japin kontributin e tyre.

*Takimi përfundoj në ora 15:30.*

Grupi punues: *Driton Barani, Njomza Hamza, Mimoza Aliu, Luljeta Mziu, Syzana Azemi, Shemsije Zeqiri, Refik Azemi.*

Me respekt!

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

---

**23.01.2024**
**14:00h**
**Salla e Kuvendit**

**Lista e pjesëmarrjes në diskutimin publik për *"Planin e Veprimit për Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024 - 2026"***

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | Faruk Axdiu | |
| 2 | Haki Behrami | |
| 3 | MERAL VEHAPI | |
| 4 | Sami Rama | |
| 5 | JAKUP GASHI | |
| 6 | NAIM ISTREFI | |
| 7 | Azem Kajtezi | |
| 8 | BURIM HAXHA | |
| 9 | Faton Hipteri | |
| 10 | Afrim Mujaj | |
| 11 | Arjanë Jerizi | |
| 12 | Hylkije Peci | |
| 13 | Ahmet Peci | |
| 14 | Elidiana Budini Haziri | |
| 15 | Abetare Ahmeti | |

| | | |
|---|---|---|
| 16 | Florina Çitaku | |
| 17 | Vjosa Veseli | |
| 18 | Julijeta Myziu | |
| 19 | Driton Berani | |
| 20 | Shemsije Seqiri | |
| 21 | Refik [illegible] | |
| 22 | Fisnik Çitaku | |
| 23 | Elhame Fejzi | |
| 24 | ERMIRA SPAHIJA | |
| 25 | Shefkije Dragaj | |
| 26 | | |
| 27 | | |
| 28 | | |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |
| 36 | | |
| 37 | | |
| 38 | | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**Nr. prot. 07-610/01-0001871/24**
**Datë: 10.01.2024**
**Mitrovicë**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c, të Ligjit Nr.03L-40 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; në nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, dhe 93, të Statutit të Komunës; nenit 7 pika 1.2, dhe 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publike në Komuna; nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për informim ORGANIZON:

## DISKUTIM PUBLIK

## PËR DRAFT PLANIN E VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në **Konsultimin Publik** për Draft planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.

**Diskutimi publik do të mbahet të martën, më datën 23.01.2024, në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 14:00.**

Njëkohësisht të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 30 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes e-mail-it të DKA-së: **dka.mitrovica@rks-gov.net**

Draft planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 po ashtu mund ta gjeni të publikuar ne ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar në linkun: **https:// kk.rks-gov.net /mitroviceejugut/ category/ shpalljet/njoftimet/**

**Drejtorja e DKA-së**

Dr. Drita Kadriu